



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:019423
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05497690

Ac.nr.4440/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Nehat Idrizi dhe Dardan Kadolli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses B.S. nga Ferizaj, rr. “.....” nr., të cilën e përfaqëson L.Q.I. avokate në Ferizaj, sipas autorizimit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S... ” sh.a., me seli në Prishtinë, rr. “...”, pn., Lagjja “...”, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar A.N., sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së paditëses dhe ankesës së të autorizuar të paditurës të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.272/20 i datës 09.07.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e paditëses B.S. nga Ferizaj, rr. “.....” nr., dhe ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S... ” sh.a., me seli në Prishtinë, rr. “...”, pn., Lagjja “...”, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.272/20 i datës 09.07.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.272/20, të datës 09.07.2020, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të aprovohet pjesërisht kërkesëpadija e paditëses B.S. nga Ferizaj, rr. “.....” nr., si e bazuar. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të detyrohet e paditura KS “..... ”, me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të shpërblimit të dëmit jomaterial dhe material,

t'ia paguajë dhe atë për dhimbje trupore-fizike shumë prej 1.700.00 €, për frikë të pësuar shumë prej 900,00 €, për kujdes nga personi i tretë shumë prej 140.00 €, për ushqim të përforcuar shumë prej 210.00€. Në pikën III, të dispozitivit ka vendosur që të refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses mbi lartësitë e shumave të aprovuara në pikën dy (II), të dispozitivit dhe atë për dhimbje trupore-fizike shumë prej 800.00€, për frikë të pësuar shumë prej 100.00€, për kujdes nga personi i tretë shumë prej 1,860.00 €, për ushqimit të përforcuar shumë prej 790.00€, për shpenzimet e mjekimit shumë prej 700,00 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumë prej 2.500,00€. Në pikën IV, të dispozitivit ka vendosur që të: Detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shumat e cekura në pikën II, të dispozitivit, në shumë të përgjithshme prej 2,856,00€, të gjitha me kamatën ligjore prej 8 %, nga data 01.07.2020, deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 869 €, të gjitha në afat prej 15 dite, pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi e autorizuar e paditëses në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj si të bazuar ankesën e paditëses, ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e detyruar të paditurën që paditëses t'ia kompensoj shumat në emër të dëmit material dhe jomaterial me kamatë 8 % nga dita e dorëzimit të padisë e deri në pagesën e plotë, duke përfshirë edhe kompensimin e shpenzimeve të procedurës në shumë prej 1.162 €, shpenzimet e eksperteve mjeko - ligjor si dhe shpenzimet e avokatit sipas tarifës së OAK-së.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ashtu që të gjykojë shumë prej 650 €, ndërsa shumë përtej kësaj lartësie prej 1.300 €, ta refuzojë si të pabazuar.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesat janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarës së saj, me datën 30.05.2014, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës, të precizuar si në parashtresën e datës 29.05.2017, me të cilën ka kërkuar që të: Aprovohet kërkesëpadija e paditëses B.S. nga Ferizaj, rr. "....." nr. ..., në tërësi si e bazuar, II. Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "S....." sh.a., me seli në Prishtinë, rr. ".....", që paditëses t'i kompensoj për dëmin e shkaktuar pa fajin e saj me rastin e aksidentit të komunikacionit rrugor të datës 30.08.2012 dhe atë: në emër të dëmit jomaterial për dhimbjet fizike shumë prej 2.500€, për frikën e përjetuar shumë prej 1.000€, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 2.500 €, në emër të dëmit material: për shpenzimet e mjekimit shumë prej 700 €, për ushqim të përforcuar shumë prej 1.000 €, për ndihmë dhe kujdes të huaj shumë prej 2.000 €, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 12% dhe atë nga dita e dorëzimit të kësaj padie në gjykatë e deri në pagesën e plotë. Obligohet e paditura që paditëses në emër të shpenzimeve të

procedurës kontestimore t'i paguaj shumën prej 759€, shpenzimet për ekspertët mjeko ligjor si dhe shpenzimet e avokatit sipas rregullores tarifore të OAK-së, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, duke vepruar sipas padisë së paditëses me aktgjykimin C.nr. 384/14 të datës 31.05.2017, ka vendosur që të: Aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditëses B.S. nga Ferizaj, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarës së paditëses dhe ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të paditurës, me aktvendimin Ac.nr. 3171/17 të datës 24.01.2020, ka vendosur që të aprovohen të themelta ankesa e të paditurës KS "S...", me seli në Prishtinë dhe ankesa e të autorizuarës së paditëses B.S. nga Ferizaj, Prishtet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr. 384/14 i datës 31.05.2017 ashtu që lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje, me vërejtje dhe sugjerime si në aktvendim.

Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.272/20, të datës 09.07.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: në këtë procedurë ka gjetur se ndërmjet ndërgjyqësve nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, por vetëm lartësia e saj. Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit jo material dhe material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 LPK-së dhe në kuptim të dispozitave të neneve 136, 159, 169, 183, dhe 961 të LMD-së, duke u bazuar në mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. Xhemajl Selmani ortoped-Traumatolog dhe Dr. Shpend Haxhibeqiri psikiatër, të cilëve gjykata ia ka falur besimin në tërësi, mendimin i cili e ka dhënë në seancën e dt.02.05.2017, dhe atë të datës 22.05.2017, si dhe dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës të cilat janë administruara si prova në këtë çështje juridike. Sa i përket kompensimit të dëmit material dhe atë për kujdes nga personi i tretë dhe ushqim të përforcuar, për dallim kur ka vendosur me aktgjykimin herën e parë e ka ndryshuar bindjen për faktin se duke u nisur edhe nga praktika gjyqësore, një kompensim i tillë u takon të dëmtuarve në aksidentet e trafikut, në rastin konkret edhe paditëses, pavarësisht se a prezantojnë apo jo ndonjë faturë. Gjykata ka konsideruar se lartësia e aprovuar në emër të shpërblimit të dëmit jo-material dhe material është shpërblim i drejtë e që paraqet një formë të satisfacionit që paditësja me këto mjete të plotësoj nevojat dhe të mirat materiale të dëmtuara që përndryshe nuk paraqesin si shpërblim absolut të dëmit.

Për lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket dëmit material dhe jomaterial, gjykata e shkallës së parë në cilësinë të provës ka marr për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. Xhemajl Selmanaj, ortoped - traumatolog dhe Dr. Shpend Haxhibeqiri psikiatër, të cilët në mendimin e tyre profesional të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 02.05.2017 dhe 22.05.2017, kanë konstatuar se: paditësja si pasojë e këtij aksidenti, ka pësuar këto lëndime trupore: përdredhje të qafës dhe ndrydhje të gjoksit dhe të barkut, të cilat lëndime kualifikohen si lëndime të lehta trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve, paditësja ka përjetuar dhimbje fizike dhe atë: dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 20 minuta, dhimbje fizike me intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 24 orë, dhimbje fizike me intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 14 ditë, dhimbjet fizike me intensitetit të ulët ka edhe tash e kësaj dite. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka pasur. Shëmtim trupor nuk ka pasur. Ndihma e huaj ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 14 ditësh. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 21 ditësh. Rehabilitimi klimatik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 20

ditësh brenda vitit të parë dhe 10 ditë tjera për vitin e dytë pas aksidentit. Si pasojë e këtij aksidenti, paditësja ka përjetuar frikë dhe atë: frikë primare e cila ka zgjatur disa 2-3 sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 4 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 2 muaj, frikë sekondare me intensitet të ulët janë përcjell kohë pas kohe me rikujtim të ngjarjes.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar neneve 136, 159, 169, 183 dhe 961 të LMD-së. Për kamatën gjykata iu ka referuar nenit 382 të LMD-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452 paragraf 1 dhe 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit, kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, po ashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2, pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjeshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pakontestuar e ka vërtetuar faktin se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur me datë rreth orës minuta, në rrugën magjistrale P - P, përkatësisht në vendin e quajtur “”, Komuna e Suharekës. Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguruar tek e paditura, shkaktari kryesor i cili ka përgjegjësi ekskluzive dhe të vetme në shkaktimin e këtij aksidenti është drejtuesi i automjetit i tipit “”, me targa të regjistrimit, të cilin në momentin e aksidentit e drejtonte Xh.G. nga fshati, Komuna e Suharekës, i siguruari i këtu të paditurës. Paditësja në cilësinë e bashkudhëtares në automjetin “.....” me targa të regjistrimit, nuk ka kontribuar në shkaktimin e këtij aksidenti. Të gjitha këto rrethana nuk janë kontestuar nga palët. E paditura gjatë shqyrtimit kryesor në shkallë të parë, nuk e ka kundërshtuar bazën juridike sa i përket shkaktarit të aksidentit, siç ka deklaruar përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 19.04.2017, nuk e ka kundërshtuar faktin se paditësja ka pësuar lëndime të lehta trupore, nuk ka e kontestuar faktin se paditësja ka përjetuar dhimbje fizike dhe frikë, si pasojë e këtij aksidenti, siç kanë deklaruar ekspertët mjekësor në mendimin e tyre profesional dhe në këtë kuptim gjykata e shkallës të parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike. Në këtë rast e paditura i ka pohuar pothuajse të gjitha faktet e theksuara më lartë dhe më qëllim që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje, në fjalën përfundimtare të datës 30.05.2017, përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës i ka ofruar ofertë në lartësi prej 1.000€, të cilën ofertë paditësja nuk e ka pranuar. E paditura edhe pse e ka kundërshtuar lartësinë e kërkesëpadisë gjatë shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë e njëjta me asnjë provë bindëse nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve nga padia edhe pse ka pasur për detyrë ta bëjë një gjë të tillë në kuptim të nenit 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësve, gjen mbështetje në nenin 136, 140 dhe 159 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 Dhjetor 2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”, me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ”, ndërsa me nenin 159 përcaktohet se: “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit ”.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me kërkesëpadinë sa i përket dëmit jomaterial dhe atë për: dhimbjet fizike dhe frikën e përjetuar, Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këto kategori të dëmit në atë mënyrë që shumat e gjykuara janë në ekuivalencë më të mirën e shkelur/cenuar, duke siguruar që kompensimi të shërbej si satisfakcion për paditësen. Gjykata drejtë ka vlerësuar dhe vendosur sa i përket këtyre kategorive të dëmit jomaterial sepse vlerësimi i gjykatës është në harmoni edhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor të cilët kanë konstatuar se paditësja ka përjetuar dhimbje fizike dhe frikë të konstatuar si më lartë, e rrjedhimisht edhe me rrethanat tjera të cilat i ka marrë në konsideratë gjykata e të cilat ndikojnë në përcaktimin e lartësisë, siç është në këtë rast natyra dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësja, llojin, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika tek paditësja si dhe rrethanat tjera si moshën e paditëses dhe praktikën e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 183 të LMD-së, për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadisë rreth kompensimit të dëmit material dhe atë: për ndihmën dhe kujdesin e personit tjetër dhe për ushqimin e përforcuar, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit ”. Në këtë rast paditëses i takon e drejta në kompensimin e dëmit material, për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar edhe përkundër faktit se paditësja për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë vlerëson se duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjykata ka konstatuar se në këtë rast paditësja ka pasur nevojë për ndihmë të huaj prej 14 ditë dhe ushqimi të përforcuar në kohëzgjatje prej 21 ditë, ku të njëjtës i takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara, pasi që edhe më vetë kriteret e caktuara nga Kompanitë e Sigurimeve në Kosovë, të cilat nuk janë obliguese për gjykatat me rastin e vendosjes, por mund të merren si kritere orientuese, rezulton se të njëjtat në rastet e aksidenteve të komunikacioneve, të dëmtuarve iu njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar dhe për kujdes nga personi i tretë. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës për këto kategori të dëmit është reale në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihmë

dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, me të cilën është refuzuar kërkesëpadia e paditëses për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial mbi shumat e gjykuara, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për shkak se në këtë rast shumat e kërkuara nga paditësja kanë qenë të larta në krahasim me lëndimet e natyrës së lehtë të konstatuara nga ekspertet mjekësor dhe se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do ti shërbente qëllimit të kompensimit të dëmit. Po ashtu sa i përket kompensimit të dëmit material për shpenzimet e mjekimit, në këtë rast e njëjta nuk ka ofruar prova që vërtetojnë këtë kategori të dëmit material, e që ka qenë e obliguar për një gjë të tillë, në kuptim të neneve 7 paragraf 1, e lidhur me nenin 319 paragraf 1 të LPK-së.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, llogaritja e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 09.07.2020, e deri në pagesën definitive, sepse paditësja për dëmin dhe lartësinë e tij, ka ra në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e saj për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit nga shqyrtimi i shkresave të lëndës konstaton se gjykata e shkallës së parë me rastin e përpilimit të aktgjykimit të atakuar, në pikën IV, të dispozitivit, ku është shkruar detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shumat e cekura në pikën II, të dispozitivit në shumë të përgjithshme prej 2,856€, në fakt duhet të ishte në shumën e përgjithshme prej 2.950€. Kjo gjykatë vlerëson se shuma e referuar në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është gabim teknik në të shkruar dhe si i tillë nuk ka asnjë ndikim në mënyrën e vendosjes, gjersa nëse paraqet pengesa për përmbarim në të ardhmen, në çdo kohë sipas kërkesës së palëve, apo edhe sipas detyrës zyrtare, gjykata e shkallës së parë do të mund ta bënte korrigjimin e aktgjykimit të atakuar me aktvendim të veçantë, në kuptim të dispozitave të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4440/20, me datë 13.03.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli